

INTERNSHIP

"Departamenti i Prodhimit - KRACO"

Programi i internship-it KRACO në **Prodhim** është një mundësi e shkëlqyer për një karrierë të suksesshme profesionale pranë kompanisë sonë në fushën e prodhimit, planifikimit, cilësisë dhe aftësimit tekniko-inxhinierik, etj. Inkurajohen që të aplikojnë nxënës të shkollave të mesme teknike (në vitin e fundit të studimit) dhe studentë të nivelit Bachelor ose Master që vijojnë studimet në fushën e inxhinierisë: Mekanikë, Inxhinieri Ekonomike, Prodhim dhe Menaxhim Industrial, Mekatronikë, etj të ngjashme.


Të gjithë studentët/nxënësit e interesuar mund të aplikojnë individualisht duke dërguar CV (Curriculum Vitae) në postën elektronike: hr@kraco.al

Afati i aplikimit është deri më **21 Maj 2023**.

Programi **INTERNSHIP "Departamenti i Prodhimit - KRACO"**, do ju ofrojë studentëve një mundësi formimi profesional në prodhim dhe mundësi punësimi. Pas përzgjedhjes së aplikantëve, programi i internship-it do të shtrihet në dy faza:

- o trajnim hyrës;
- o trajnim në punë.

Kohëzgjatja e internshipit është **deri në tre muaj dhe i pagueshëm**, me program të thelluar profesional e praktik si më poshtë:



Aplikantit të përzgjedhur do ti caktohet një supervisor/trajner që orienton dhe mbikëqyr ecurinë e tij. Në fund të trajnimit ai do të pajiset me vlerësimin e performancës dhe certifikate trajnimi duke i ofruar mundësi rekrutimi si staf i kompanisë, nëse performanca e tij ka qenë shumë e lartë.

Gjatë zhvillimit të këtij programi trajnimi, në fazën e parë "trajnim hyrës" kandidatët do të aftësohen me njohuri të përgjithshme në:

a) Trajnim bazë nga Burimet Njerëzore:

- Kraco: misioni dhe vizioni i kompanisë;
- Organigrama dhe funksionet raportuese;
- Bazat e dokumentacioneve/dosjes personale të punonjësve;
- Vlerësimi i performancës në trajnim dhe në punë;
- Kodi i etikës në përgjithësi dhe veçanërisht në veshje; etj.

b) Trajnim standard i produkteve:

- Certifikimet "Kraco";
- Njohja me produktet "Kraco" dhe "PL";
- Njohja me procesin e prodhimit dhe funksionet e makinerive;
- Njohja me ambalazhet; etj.

Ndërsa faza e dytë e zhvillimit të pranimit do të jetë në Departamentin e Prodhimit "trajnim në punë":

c) Trajnim bazë nga Planifikim-Prodhi

- Kuptimi i planit ditor dhe modulet e tij;
- Plotësime të moduleve të ndryshme të prodhimit sipas makinerive;
- Njohja me format e shpalljes së realizimi i palint sipas makinerive;
- Ndërveprimi midis makinerive dhe reparteve të prodhimit;
- Format e raportimit në raste të avarisë së makinerive;
- Identifikimi i skarcove dhe njohja e udhëzimeve të trajtimit të tyre; etj.

d) Trajnim nga Departamenti i Cilësië

- Informimi i plotë i standardeve të higjenës;
- Informim i plotë i cilësisë së prodhimit të produktit;
- Njohja e komponentëve të prodhimit dhe ruajtja e cilësisë gjatë prodhimit;
- Kutimi i jo-konformiteteve kryesore dhe bashkëpunimi me operatorin e cilësisë në linjë; etj.

e) Trajnim nga Departamenti Teknik

- Kuptimi i detajuar i proceseve të punës së makinerisë;
- Aftësimi teknik i proceseve teknologjike të makinerisë;
- Automatizimi i makinerive;
- Aftësimi teknik i mirëmbajtjes së makinerisë;
- Njohja e avarive kryesore të makinerisë dhe trajtimi i problemit;
- Njohja e rregullave të sigurisë në punë; etj.

Në vijim tregohet kalendari i përgjithshëm i trajnimit:

Faza e Trajnimit	Kohëzgjatja	Departamenti Përgjegjës	Lloji i Trajnimit	Trajnuesi/Supervizori
Faza I	Java I	Burimet Njerëzore	Trajnim bazë	Trajnues – Burimet Njerëzore
		Burimet Njerëzore	Trajnim standard i produkteve	Trajnues – Burimet Njerëzore
Faza II	Java II	Departamenti i Prodhimit	Trajnim bazë Planifikim- Prodhimi	Trajnues – Zyra e Planifikimit
		Departamenti i Cilësië	Trajnim mbi cilësinë e produkteve/komponentëve	Trajnues – Operator cilësie në linjë
	Java III - VI	Departamenti i Prodhimit	Trajnim mbi proceset teknologjike	Trajnues – Specialist teknik
	Java VII- XII	Departamenti Teknik	Trajnim mbi avaritë bazë të makinerive, mirëmbajtje dhe automatizim, etj.	Trajnues – Inxhinier